



SIT

Raporti Vjetor 2023

Përgatitur nga:

Kadri Gashi
Njomza Berisha
Agon Osaj

Janar – Dhjetor 2023



VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM I ORGANIZATËS	3
Misioni	4
Vizioni	4
Arritjet kryesore të SIT gjatë vitit 2023:	4
Statusi Financiar i Fundvitit 2023 – Përmbledhja e Financave	4
Burimet Kryesore të Financimit	5
Pikat kryesore financiare:	5
Figura 1. Krahasimi Financiar 2022 vs 2023	5
Projektet e Departamentit të Këshillimit:	6
Këshillim për Parandalimin 3.0 (C4P 3.0) (Janar - Dhjetor 2023)	7
Projektet e Departamentit të Shërbimeve Sociale:	7
Youth 4 Inclusion, Equality & Trust (Qershor – Shtator 2023)	8
Youth 4 Inclusion, Equality & Trust: (Shtator 2022 – Shkurt 2024)	8
F4Y - Future4You(th) (Mars 2021 – Janar 2024)	9
Youth Voices, Youth Choices (Janar 2021 - Qershor 2023)	10
Pokë the Bubble (Maj 2023- Gusht 2026)	11
DouActism (Janar 2023 - Dhjetor 2024)	12
Empowering Kosovo's Youth for Intra-community Cohesion	13
Positive Fatherhood (Korrik-Shtator 2023)	14
Enhancing Youth Voice for Diversity and Inclusion (Youth INC.)	15
Departamenti i Hulumtimeve:	16
Raporti Vjetor 2023 – Fushatat	17
Dita Zero Diskriminim (1 Mars):	18
Dita Ndërkombëtare e Rinisë (11-12 gusht):	18
Dita Kundër Dhunës:	18
Dita Ndërkombëtare e Paqes:	19
16 Ditët e Aktivizmit:	19
Festivali i Baballarëve Edicioni i Pestë	20
Tuneli i Fundit - Tregimete të Paharruarave Edicioni V :	21
Të tjera:	22
Arritja Digjitale	22
Platformat e SIT	23
Çka na pret në vitin 2024	23
Stabiliteti i SIT	24
Projektet e reja 2024:	24
Strategjia e SIT 2024 - 2028	25



Në vitin 2023, Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime (SIT) ka shënuar arritje të rëndësishme, duke forcuar rolin e saj si lider në iniciativat edukative dhe të mirëqenies sociale në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Arritjet kryesore përfshijnë **integrimin e suksesshëm të Programit Y** në “Modulet Tematike për Mbrojtjen e Fëmijëve” si pjesë e **edukimit formal** në Kosovë, dhe themelimin e SIT si **Qendër e Ekselencës** në **“Doughnut Economics”** në edukimin joformal në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Përveç kësaj, SIT zhvilloi **katër manuale** që trajtojnë çështje të rëndësishme sociale si gjuha e urrejtjes dhe bullizmi dhe inicoi **Programin Y+** (të rinjtë në rrezik) në shërbimet korrektuese të Kosovës, si në qendrat e hapura ashtu edhe të mbyllura në Lipjan. **Themelimi i Klubit “Bonu Burrë”** në Qendrën Korrektuese në Lipjan ilustron më tej përkushtimin e SIT për iniciativa rehabilituese dhe sociale.

Janë realizuar programe trajnimi për profesionistët në institucione të ndryshme publike, përfshirë Policinë e Kosovës dhe mësimdhënësit/et e shkollave, duke forcuar kapacitetet e tyre për të adresuar sfidat shoqërore. SIT pati gjithashtu një **rritje prej 18.47% në buxhetin vjetor** krahasuar me vitin 2022, rreth 80 seanca këshillimi për kryerësit e dhunës, trajnimi i afërsisht 712 të rinjve/rejave, implementimi i 8 fushatave ndërgjegjësuese të komunitetit dhe një zgjerim i audiencës së mediave sociale në mbi 150,000 persona. Këto arritje nënvizojnë përkushtimin e SIT për të nxitur një shoqëri më të sigurtë, më të arsimuar dhe të ndërgjegjshmeshoqërore në Kosovë dhe më gjerë.

Në këtë raport vjetor, ne do të mbulojmë një sërë temash të rëndësishme që lidhen me aktivitetet e SIT në vitin 2023. Ne do të shqyrtojmë projektet e zbatuara, duke u thelluar ndikimin dhe metodologjitë e tyre. Programet e reja të nisura në SIT do të përshkruhen, duke u fokusuar në qëllimet e tyre dhe kontributet e mundshme shoqërore. Do të elaborojmë fushatat kryesore të vitit, duke demonstruar efektivitetin e tyre në promovimin e ndërgjegjësimit shoqëror. Për më tepër, do të parashikojmë projektet e ardhshme të SIT për vitin 2024 dhe do të ofrojmë një përmbledhje të planit strategjik për 2024-2028, duke përshkruar drejtimin dhe objektivat e ardhshme të organizatës. Raporti do të prekë gjithashtu ngjarje dhe aktivitete të tjera të dukshme nga viti 2023, duke përmbledhur përpjekjet gjithëpërfshirëse të SIT në mirëqenien sociale dhe edukimin. Ky dokument shërben si një pasqyrim konciz por i plotë i angazhimit të SIT për të nxitur ndryshime pozitive në komunitet.



Misioni

SIT ka për qëllim të promovojë dhe të krijojë një shoqëri të barabartë për të gjithë. Kështu që, ne trajtojmë disa nga problemet më sfiduese të të drejtave të njeriut në shoqërinë tonë që na pengojnë për të arritur barazi, paqe, dhe zhvillim, përfshirë këtu dhunën në familje dhe dhunën me Bazë gjinore. Ne synojmë të arrijmë këtë duke përfshirë njerëz të të gjitha prapavijave, pa marrë parasyh gjininë, orientimin seksual apo ndonjë kategori tjetër të identitetit.

Vizioni

Ne synojmë një shoqëri gjithëpërfshirëse ku të gjithë ndjehen të sigurt, të barabartë, dhe mund të arrijnë potencialin e tyre pavarësisht identiteteve të tyre sociale.

Arritjet kryesore të SIT gjatë vitit 2023:

- 10 projekte të implementuara;
- Programi Y i integruar nëe “Modulet Tematike për mbrojtjen e fëmijëve” si pjesë e edukimit formal në Kosovë;
- SIT u bë Qendër e Ekselencës në “Doughnut Economics” në edukimin joformal në Ballkanin Perëndimor;
- 4 manuale u zhvilluan për trajtimin e çështjeve të tilla si gjuha e urrejtjes, bullizimi, reagimi ndaj dhunës;
- Filloi zbatimi i Programit Y+ në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në qendrat e hapura dhe të mbyllura korrektuese në Lipjan;
- U bë themelimi i klubit “Bonu Burrë” në Qendrën Korrektuese në Lipjan;
- Janë trajnuar profesionistë/e të institucioneve publike si Policia e Kosovës, mësimëdhënës/e nga shkolla të ndryshme, etj;
- Buxheti i SIT u rrit rreth 45% nga viti 2022;
- U mbajtën rreth 80 seanca këshillimi për kryerësit e dhunës;
- Janë trajnuar rreth 712 të rinj/reja;
- U implementuan 8 fushata të ndërgjegjësimit të komunitetit për çështjet sociale;
- Mbi 150,000 mijë audiencë në rrjete sociale.

Statusi Financiar i Fundvitit 2023 – Përmbledhja e Financave



Burimet Kryesore të Financimit

Suksesi financiar i vitit 2023 u përforcua nga kontributet e disa financuesve kryesorë, duke përfshirë:

- CARE International në Ballkan
- Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA)
- Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara (UNFPA)
- United Nations Kosovo Team (UNKT)
- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)
- Komisioni Evropian
- Erasmus +
- Fondi për Ndërtim të Paqes i Kombeve të Bashkuara (UNPBF)
- Danish Refugee Council (DRC)
- Swedish International Development Cooperation Agency (SIDA)
- Koalicioni K10
- Women's International League for Peace and Freedom (WILPF)

Pikat kryesore financiare:

Rritja e të ardhurave: Të ardhurat tona totale dëshmuar një rritje të jashtëzakonshme rreth **18,47%**, duke u rritur nga **€208,986.06** në **2022** nga rreth **€247,588** në **2023**. Kjo rritje e konsiderueshme është një dëshmi për strategjitë tona efektive për ngritjen e fondeve dhe zgjerimin e bazës sonë të financimit, duke reflektuar rritjen e përmirësuar të bazës sonë të financimit, stabilitetin financiar dhe aftësinë për të siguruar burime të ndryshme financimi.

Shpenzimet e Burimeve Njerëzore: Shpenzimet për personelin patën një rritje prej **35.80%**, nga **€119,302.41** në **2022** në rreth **€163,927.18** në **2023**. Kjo rritje i atribuohet zgjerimit të personelit për të mbështetur operacionet e zgjeruara dhe rritjen e përfitimeve dhe kompensimit të punonjësve/eve.

Shpenzimet operative: Shpenzimet operative u ulën për **7,2%**, duke treguar një efikasitet financiar në zgjerimin e aktiviteteve dhe nismave të projekteve tona. Ulja nga **€89,684** në vitin **2022** në rreth **€83,661** në vitin **2023** dëshmon përkushtimin tonë operacional dhe infrastrukturën për të mbështetur portfolion tonë në rritje të projekteve dhe programeve.

Krahasimi Financiar 2022 vs 2023





Figura 1. Krahasimi Financiar 2022 vs 2023

Përgjithësisht, pasqyra financiare për vitin 2023 pasqyron rritjen e fortë dhe të qëndrueshme të organizatës sonë. Përafrimi i rritjes së veprimarisë dhe burimeve njerëzore me të ardhurat tona në rritje tregon menaxhimin tonë efektiv financiar. Këto rezultate na mundësojnë një pozitë të mirë për sukses të vazhdueshëm dhe përpjeke me ndikim në të ardhmen. Fokusi ynë mbetet në ruajtjen e këtij momenti pozitiv dhe sigurimin e shëndetit financiar afatgjatë dhe ndikimit të organizatës.



Projektet e Departamentit të Këshillimit:



Këshillimi për Parandalimin 3.0 (C4P 3.0) (Janar - Dhjetor 2023)


Në implementim nga janari deri në dhjetor 2023, projekti C4P 3.0, i financuar nga zyra e UNFPA-së në Kosovë, ka synuar reduktimin e dhunës me bazë gjinore (DhBGj) dhe dhunës në familje (DhF) duke punuar drejtpërdrejt me burrat ushtrues të dhunës. Janë mbajtur gjithsej 80 seanca këshillimi, duke çuar në ndryshime të rëndësishme në sjellje. Bashkëpunimi me Shërbimin Sprovues të Kosovës ka rezultuar me referime të 11 kryerësve të dhunës. Projekti përfshiu gjithashtu 12 sesione avokimi dhe trajnimi me akterë institucionalë dhe studentë të Fakultetit Juridik. Pika kryesore ishte Konferenca e Maskulinitetit Toksik, e fokusuar në përfshirjen e grupeve të ndryshme në luftën kundër DhBGj/DhF. Gjithashtu, 39 studentë/e të Fakultetit Juridik u trajnuan për t'i çuar më tej këto përpjekje.





Youth 4 Inclusion, Equality & Trust (Qershor – Shtator 2023)


Ky projekt katërmujor i financuar nga UNDP, nga qershori deri në shtator 2023, ka angazhuar 115 të rinj/reja në mbarë Kosovën. Projekti ka synuar t'i fuqizojë ata/o për të trajtuar çështje si dhuna, bullizimi, gjuha e urrejtjes dhe mizogjia nga këndvështrimi i kalimtarit, duke i transformuar ata në kalimtarë aktivë përmes kampeve/trajnimeve rinore. Përtej trajnimit të drejtpërdrejtë, projekti ndikoi në 65 të rinj/reja të tjerë/a përmes fushatave të mediave sociale, duke prodhuar 11 produkte përmes fushatave. U zhvilluan dy manuale “Si të organizohet një fushatë për ndërhyrjen e kalimtarëve” dhe “Anti-bullizimi dhe anti-urrejtja”, duke ofruar udhëzime praktike për të luftuar këto çështje. Projekti prodhoi gjithashtu edhe dokumentarin “From Here to There”, duke theksuar përpjekjet bashkëpunuese të vajzave të reja me prejardhje të ndryshme etnike, duke theksuar integrimin në komunitet. U shënuan ditë ndërkombëtare, duke përforsuar mesazhin dhe shtrirjen e projektit.





Youth 4 Inclusion, Equality & Trust: (Shtator 2022 – Shkurt 2024)

"Youth 4 Inclusion, Equality & Trust" projekt i financuar nga UNFPA - zyra në Kosovë, fokusohet në trajnimin e grupeve të të rinjve/rejave Shqiptarë/e, Serbë/e, Romë/e, Ashkali/e dhe Egjiptianë/e në të menduarit kritik dhe kreativ. Nëpërmjet edukimit joformal, projekti ka synuar të fuqizonte rreth 150 pjesëmarrës/e për të sfiduar stereotipet sociale dhe për të ndërtuar identitete të hapura. Iniciativa përfshiu aktivitete në gjashtë (6) komuna, duke mbuluar tema si dialogu, avokimi, dhe të drejtat e njeriut. Një rezultat i rëndësishëm ishte zhvillimi i një manuali për mendimin kritik, duke përfshirë metoda të ndryshme si komunikimi jo i dhunshëm dhe shprehjet artistike, të destinuara për përdorim si në arsimin joformal ashtu edhe në atë formal. Manuali përfshin një sërë metodash si komunikimi jo i dhunshëm, zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, teknikat e ndërtimit të ekipit, fotografia, vizatimi, punime artizanale, etj., për të luftuar paragjykimet ekzistuese dhe stereotipet. Për më tepër, projekti frymëzoi pjesëmarrësit/et të krijonin artikujpër çështje të ndjeshme si barazia gjinore dhe kohezioni social. Poashtu u lansuan tetë (8) fushata për të shënuar ditët përkatëse ndërkombëtare, duke rritur ndikimin dhe shtrirjen edukative të projektit.





F4Y - Future4You(th) **(Mars 2021 – Janar 2024)**

Projekti “E ardhmja për rininë”, synon të krijojë shoqëri pozitive, jo të dhunshme në Serbi, Kosovë, Shqipëri dhe Bosnje-Hercegovinë, duke reduktuar dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve. Ky projekt, i bazuar në Iniciativën e Burrave të Rinj, u fokusua në institucionalizimin e Programit Y, një program i aftësive jetësore transformuese gjinore, në sisteme edukative formale.

Arritjet kryesore përfshijnë integrimin e Programit Y në “Modulet Tematike për Mbrojtjen e Fëmijëve”, në sistemin formal të arsimit të Kosovës, implementimin e programit në Kolegjin UBT dhe departamentin e Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës, dhe mbajtjen e punëtorive në Shkollën e Mesme Teknike, “28 Nëntori” në Prishtinë. U krijuan Memorandume të Mirëkuptimit (MoUs) me institucione të ndryshme arsimore dhe të drejtësisë për zbatimin e Programit Y dhe Y+ në shkolla dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës – Lipjan. Projektigjithashtu përfshin formimin e Klubit “Bonu Burrë” në Shërbimin Korrektues të Kosovës në qendrën në Lipjan dhe trajnimin e mësimitdhënësve/eve për Programin Y në Prishtinë. SIT nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Shkollën Fillore “Naim Frashëri” në Prishtinë për implementimin e Programit E (Shkollat fillore) dhe implementimin e Programit E në këtë shkollë. Gjithashtu, u organizua një konferencë në Tiranë për të promovuar barazinë dhe sjelljet jo të dhunshme. Këto përpjekje shënuan hapa të rëndësishëm në promovimin e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në Ballkanin Perëndimor.





Youth Voices, Youth Choices (Janar 2021 - Qershor 2023)

Gjatë muajit maj, përfaqësues/e nga Ministria e Shëndetësisë, ekspertë të Shëndetit dhe të Drejtave Seksuale dhe Riprodhuese ShDSR dhe përfaqësues/e të Shoqërisë Civile që punojnë në fushën e ShSR morën pjesë në takimin e nivelit të lartë në Tiranë dhe patën mundësinë të punojnë në grupe me palët e interesit dhe vendimmarrësit, nga vendet e tjera të rajonit, duke kontribuar kështu në një qasje më gjithëpërfshirëse të shkëmbimit të praktikave dhe politikave të mira midis vendeve pjesëmarrëse, duke u dhënë gjithashtu të rinjve/rejave një mundësi për t'u takuar me vendimmarrësit dhe për të avokuar për temat që u interesojnë në lidhje me ShDSR.

Anëtarët/et e grupit të të rinjve nga Kosova ndoqën punëtorinë për fushatë në rrjete sociale në Maqedoninë e Veriut dhe mësuan më shumë rreth strategjive të rrjeteve sociale, si të krijojnë mesazhe të fuqishme për të mbrojtur temat me interes për ta në lidhje me ShDSR dhe si të menaxhojnë postimet dhe analitikat e rrjeteve sociale. Pas trajnimit ata mundën të zbatojnë njohuritë e marra duke qenë pjesë e fushatës së mediave sociale që u organizua në kuadër të projektit. U organizua një fokus grup përfundimtar me palët e interesit dhe ekspertë/e shëndetësorë/e për të krijuar një plan për veprimet e ardhshme që duhen zbatuar në të ardhmen.





Poke the Bubble (Maj 2023- Gusht 2026)

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të rrisë kapacitetet e grupeve profesionale të OshC-ve nga Serbia dhe Kosova për të punuar me të rinjtë/reakt nga Serbia dhe Kosova, për të qenë aktorë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm, në gjendje të angazhojnë të rinjtë dhe të rejat nga rajoni në krijimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore duke u fokusuar në çështjet e ndërsjellta. Një nga objektivat specifike të projektit është inicimi i një rrjeti të grupeve profesionale të OshC-ve nga Serbia dhe Kosova të cilët do të jenë në gjendje të zbatojnë metodologji inovative të punës me të rinjtë/rejat për adresimin e barazisë gjinore me të rinjtë dhe të rejat nga zonat më të pazhvilluara. Një objektiv tjetër i projektit është të krijojë mundësi për të rinjtë nga zonat më të pazhvilluara urbane dhe rurale në Serbi dhe Kosovë për një qasje proaktive në adresimin e roleve gjinore, normave, barazisë gjinore dhe temave të tjera të lidhura me të rinjtë në të gjitha nivelet e komunitetit.






DouActism

(Janar 2023 - Dhjetor 2024)

Projekti "DouActism" udhëhiqet nga MasterPeace Global Network dhe financohet nga Erasmus+. Projekti përfshin partneritete me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) me qendër rininë në të gjithë Ballkanin, Lindjen e Mesme dhe BE-në Perëndimore, duke përfshirë SIT në Kosovë, LDN në Liban, MasterPeace Marok, MasterPeace Holandë, dhe Lumen në Kroaci. Projekti synon të luftojë përjashtimin social, çështjet mjedisore dhe sfidat e punës për të rinjtë, veçanërisht duke u fokusuar tek gratë e reja në zonat rurale.

Një arritje kryesore e projektit **është themelimi i SIT si Qendër e Ekselencës në Ekonominë Donat për rajonin e Ballkanit**. Projekti thekson arsimin inovativ joformal (NFE), zhvillimin e manualve për NFE dhe kurseve online në shumë gjuhë si shqip, anglisht, holandisht, arabisht, kroatisht dhe frëngjisht. Aktivitetet përfshijnë një sërë iniciativash, duke përfshirë një sfidë ndërshtetërore të Sipërmarrjes Sociale, takimet e palëve të interesit, një anketë të BE-së për nevojat e OSHC-ve, trajnimin e **45 punëtorëve të rinj** dhe mbikëqyrjen e 25 projekteve të udhëhequra nga të rinjtë/rejat. Këtë vit SIT trajnoi me sukses 13 punëtorë/e të rinj/reja nga tre OJQ në Kosovë në "Ekonominë Donat" dhe Artivizzëm. Këta individë të trajnuar janë të vendosur të edukojnë të rinjtë dhe të udhëheqin zhvillimin e pesë **(5) pilot projekteve** brenda Kosovës, duke zgjeruar kështu ndikimin e projektit dhe fuke nxitur rritjen e liderëve të rinj në rajon.





Fuqizimi i të rinjve të Kosovës për kohezion brenda komunitetit (Tetor 2023 - Dhjetor 2025)

Objektivi parësor i projektit “ Fuqizimi i të rinjve të Kosovës për kohezin brenda komunitetit” është të përmirësojë aftësitë e të rinjve kosovarë, duke përfshirë grupet minoritare, për kohezion brenda komunitetit dhe krijimin e shoqërive paqësore dhe gjithpërfshirëse. Për të arritur këtë qëllim, SIT do të fuqizojë të rinjtë e Kosovës si ndërmarrës socialë, duke u mundësuar atyre të luftojnë stereotipet dhe paragjykimet me bazë etnike. Kjo nismë synon të nxisë avokues të rinj për të rritur qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj konflikteve dhe për të promovuar bashkëjetesën harmonike. Për më tepër, SIT do t'i pajisë këta liderë të rinj me aftësi jetike në aftësitë e buta, komunikim, menaxhim të projekteve dhe planifikimin e buxhetit. Në fund, qëllimi ynë është që ata të zhvillojnë pilot projekte të harmonizuara me metodologjinë e Ekonomisë Donat, e cila nga ana tjetër, do të forcojë mundësitë e punësimit për të rinjtë e Kosovës. Ky është një projekt dyvjeçar dhe do të punojë me 80 të rinj nga rajoni i Prishtinës dhe Mitrovicës. Rezultatet kryesore të projekteve janë: 4 pilot projekte, 6 iniciativa të bazuara në komunitet, 4 “Mure të lidhjes” dhe debatet “SIT and Talk”, 1 “Great Minds Meeting”. Ky projekt implementohet nga SIT i mbështetur nga Këshilli Danez i Refugjatëve (DRC) dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze në Kosovë (Sida).





Atësia pozitive (Korrik-Shtator 2023)

Në projektin “Atësia pozitive” tre pjesë kyçe punuan në mënyrë sinergjike për të ripërcaktuar rolet e atësisë dhe amësisë:

Angazhimi i Sektorit Shëndetësor: kjo pjesë i pajisi profesionistët shëndetësorë me strategji për t’i përfshirë në mënyrë aktive si baballarët ashtu edhe nënat në kujdesin shëndetësor të nënës dhe fëmijës, duke theksuar kështu rolin e të dy prindërve në zhvillimin e fëmijës.

Edukimi në Grup për Prindërit: fokusohet në lehtësimin e diskutimeve në grup midis prindërve dhe prindërve në pritje, duke përfshirë individë të rinj. Këto sesione, të udhëhequra nga punonjës shëndetësor ose lehtësues të jashtëm, inkurajojnë një shqyrtim më të thellë të ndikimeve shoqërore dhe kulturore në rolet prindërore.

Mobilizimi i Komunitetit: pjesa përfundimtare ofron mjete për aktivistët e komunitetit për të promovuar prindërimin pozitiv përmes fushatave dhe aleancave, duke synuar të kultivojë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj kujdesit dhe përgjegjësive prindërore.

Qëllimi gjithëpërfshirës i projektit është të sfidojë dhe transformojë normat tradicionale të prindërimit, duke nxitur një mjedis ku edhe baballarët edhe nënat janë të angazhuar në mënyrë të barabartë në të gjitha aspektet e jetës familjare dhe kujdestarisë.





Përmirësimi i zërave të rinisë për diversitet dhe përfshirje (Youth INC.) (Dhjetor 2023 – Nëntor 2025)

Projekti "Përmirësimi i zërave të rinisë për diversitet dhe përfshirje (Youth INC.)" që është aktiv nga dhjetori 2023 deri në nëntor 2025, bashkëpunon me partnerë nga Kosova, Hungaria, Rumania, Gjermania, Egjipti, Shqipëria dhe Izraeli. Ai fokusohet në përmirësimin e cilësisë, perceptimit dhe kapacitetit të punëtorëve rinorëj dhe të rinjve/rejave për të mësuar për diversitet dhe përfshirje. Ky projekt filloi në dhjetor 2023, dy vitet e ardhshme do të përfshijnë lloje të ndryshme të aktiviteteve të tilla si trajnime për punëtorët rinorë, modulin për mësim të bazuar në projekte (PBL), veprime lokale dhe projekte virtuale përmes ngjarjeve në internet dhe përfshirja e palëve të interesuara si vendimmarrësit dhe mediat në këto ceremoni etj.



Departamenti i Hulumtimeve:



"Të qenit burrë në shoqërinë kosovare"

Këtë vit lansuam raportin e hulumtimit të titulluar "Të qenit burrë në shoqërinë kosovare". Raporti synon të shqyrtojë mendimet dhe qëndrimet e djemve dhe të rinjve në Kosovë, duke synuar të eksplorojë kuptimin e të qenit i ri, pritshmëritë e shoqërisë ndaj sjelljes së meshkujve dhe ndikimin e këtyre pritjeve në jetën dhe marrëdhëniet e tyre.





Dita Zero Diskriminim (1 Mars):

Ne shënuam Ditën Zero Diskriminim me një shfaqje speciale të "The Green Book." Ngjarja, duke ndërthurur artin dhe aktivizmin, ngjalli një diskutim midis një grupi të ndryshëm të të pranishmëve mbi përvojat personale me diskriminimin, duke theksuar rolin tonë kolektiv në zhvillimin e një shoqërie pa diskriminim (Buxheti: €1,146.00)



Dita Ndërkombëtare e Rinisë (11-12 gusht):

Për të shënuar këtë ditë, ne organizuam punëtori gjithëpërfshirëse mbi aktivizmin rinor dhe mjedisin. Sesionet, ku morën pjesë 17 të rinj/reja, iu dedikuan zhvillimit të aftësive për leadership dhe hartimit të fushatave për qëndrueshmërinë mjedisore, duke demonstruar potencialin e të rinisë për të nxitur ndryshime pozitive. (Buxheti: €3,408.00)



International Non-Violence Day (October 2):

Në këtë ditë, ne shfaqëm dy dokumentarë dhe organizuam një panel diskutimi të fokusuar në strategjitë për të parandaluar dhunën, duke i anagazhuar pjesëmarrësit/et në dialog kuptimplotë për krijimin e një shoqërie më paqësore. Në këtë panel diskutimi, ne patëm nderin që si folëse të kishim Ministren e Drejtësisë së bashku me përfaqësuese të Qendrës Korrektuese dhe profesorë të punës sociale nga Universiteti i Prishtinës. (Buxheti: €1,030.00)



Dita Ndërkombëtare e Paqes:

Për të festuar këtë ditë, ne prodhuam një video ku shfaqen pjesëmarrës/e nga komuna të shumta në përputhje me këngën "Earth Heartbeat" të prodhuar nga MasterPeace Global Foundation. Videoja, që simbolizon unitetin dhe paqen përmes përpjekjeve bashkëpunuese, angazhoi 46 të rinj/reja në një mesazh harmonie. (Buxheti: €1,275.00)



16 Ditët e Aktivizmit:


Kjo fushatë përfshiu shfaqjen e filmit "Beyond the Walls" në Qendrat Korrektuese të Lipjanit dhe Dubravës, punëtoritë e pikturës, krijimin e një murali, duke nxitur kreativitetin dhe shprehjen si mjete për rehabilitimin dhe ngritjen e vetëdijes për dhunën në familje.

Festivali i Baballarëve | Edicioni i Pestë:



Duke festuar atësinë pozitive, ky festival angazhoi familjet në një sërë aktivitesh në Parkun e Marashit në Prizren. Duke përfshirë gara baba-fëmijë, gatim, tregime historish dhe arte kreative. Ngjarja mblodhi 60 prindër dhe 180 fëmijë, duke nënvizuar rëndësinë e përfshirjes aktive të babait në rritje të fëmijëve. (Buxheti: €7,150.00)

Tuneli i Fundit - Tregimet e të Paharruarave | Edicioni V |:



Angazhimi ynë i vazhdueshëm për të luftuar dhunën me bazë gjinore u shfaq në këtë ekspozitë, pjesë e konferencës rajonale “Të bashkuar kundër dhunës: Mjaft”. Pas katër vitesh punë me publikun e gjerë për ndërgjegjësimin për qasjen mediatike të ndjeshme gjinore, SIT këtë vit për të pestën herë shfaqti ekspozitën e Tunelit, këtë vit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Tuneli i Fundit u shfaq në konferencën rajonale “Të Bashkuar Kundër Dhunës: Mjaft”, organizuar nga Ministria e Drejtësisë më 5 dhe 6 dhjetor.

Ky tunel nxori në dritë historitë e viktimave të femicidit, duke avokuar për ndryshime sistematike dhe reagim të shtuar institucional për të mbrojtur gratë (Mbështetur nga UNDP Kosovë, UNFPA Kosovë, Women’s International League for Peace and Freedom, dhe K10)

Këto fushata pasqyrojnë përkushtimin tonë për të trajtuar sfidat shoqërore, për të mbrojtur barazinë dhe për të fuqizuar komunitetet përmes ndërgjegjësimit, edukimit dhe angazhimit aktiv. (Buxheti: €21,900.00)

Të tjera:



Gjatë gjithë vitit, pjesëmarrja jonë aktive në ngjarje dhe konferenca të ndryshme ka pasuruar ndjeshëm përvojën tonë organizative dhe ka zgjeruar këndvështrimin tonë për çështjet kryesore sociale. Ne morëm pjesë në edicionin veror të Asamblesë së Përgjithshme të YEU-së, një platformë e paçmuar për ndarjen e njohurive dhe strategjive me kolegët/et entuziastë/e të fuqizimit të të rinjve. Për më tepër, përfshirja jonë në konferencën "Progami Y+: Promovimi i barazisë dhe sjelljeve jo të dhunshme" në Tiranë ishte thelbësore në rritjen e të kuptuarit dhe qasjes tonë drejt nxitjes së barazisë gjinore dhe zbutjes së dhunës.

Konventa e 41-të e YEU-së na dha më tej një mundësi për t'u angazhuar me ide të ndryshme dhe praktika inovativenë zhvillimin e të rinjve. Edicioni dimëror i Asamblesë së Përgjithshme të YEU-së na lejoi të reflektojmë mbi ecurinë e vitit dhe të vendosim synime të reja për të ardhmen. Pjesëmarrja në "Act Now - Konferenca e Kryetarëve" na pajisi me prespektiva të reja për qeverisje vendore dhe angazhimin e komunitetit. Këto ngjarje kontribuan kolektivisht në rritjen dhe zhvillimin tonë, duke përforcuar angazhimin tonë për ndryshime pozitive sociale dhe fuqizimin e komunitetit.

Rrjetet në të cilat SIT është anëtar:

- MasterPeace Global Foundation (MP);
- Youth for Exchange and Understanding (YEU);
- MenEngage;
- European Network for the Work with Perpetrators of Domestic Violence;
- Koalicioni për shëndetësi (K10);
- Act NOW;
- Grupi për Siguri dhe Gjini (SGG);
- European Network of Youth Centres;
- International Planned Parenthood Federation European Network (IPPF);
- MenCare/Fatherhood.



Në vitin 2023, platformat tona dixhitale shfaqën rritje dhe angazhim të jashtëzakonshëm, duke reflektuar efektivitetin e përmbytjes dhe strategjive tona të shtrirjes.

- Faqja jonë në Facebook arriti 128,980 individë, një dëshmi e natyrës bindëse të përmbytjes sonë dhe përputhjesë saj me audiencën tonë.

- Shtrirja jonë në Instagram u rrit në 12,000, e nxitur nga postimet organike.

- Ne mirëpritëm 150 ndjekës të rinj, një arritje e rëndësishme e realizuar pa reklama me pagesë, duke nënvizuar tërheqjen e përmbytjes sonë.

- I lansuar në mars 2023, buletini ynë u bë shpejt një mjet kyç komunikimi me një bazë prej 64 abonentësh, duke përfshirë 40 lexues të dedikuar.

- Një lexueshmëri prej 40% tregon rëndësinë dhe vlerën e buletinit për audiencën tonë.

- Buletini tërhoqi me sukses 30% të lexuesve të tij në faqen tonë të internetit dhe platformat e mediave sociale, duke rritur gjurmën tonë të përgjithshme dixhitale.

Këto metrika jo vetëm që demonstrojnë rritjen e pranisë sonë dixhitale, por edhe besimin dhe interesin që përmbytja jonë mledh në audiencën tonë. Të dhënat e vitit 2023 konfirmojnë suksesin e strategjive tona në angazhimin dhe zgjerimin e komunitetit tonë online.

Platformat e SIT

www.sit-ks.org

www.sitandbreaktheice.org

www.sitandtalk.org/

www.sitkosova.org

www.ks.masterpeace.org/

<https://www.kujdessex.net/>



Stabiliteti i SIT

Strategjia e ardhshme e qëndrueshmërisë e SIT përqendrohet në fuqizimin e të rinjve me programe inovative dhe me ndikim. Projektet tona kryesore, duke përfshirë "Këshillim për Parandalim (C4P 4.0)," "Fuqizimi i të rinjve të Kosovës për kohezin brenda komunitetit", "Poke the Bubble," "DouActism", dhe "Youth INC," janë përshtatur për të nxitur zhvillimin e të rinjve/rejave në fusha si kohezioni social dhe edukimi joformal. Fokusi strategjik brenda Departamentit të Shërbimeve Sociale për 2024-2028 është në Artvizëm dhe "Ekonomia Dnat", që synon pajisjen e të rinjve/rejave me aftësi thelbësore për punësim, aftësi të buta dhe një përkushtim ndaj artit si një formë aktivizmi për të mbështetur perspektivën e punës në Kosovë dhe promovimi i barazisë gjinore dhe mënyrave të shëndetshme të jetesës. Kjo mbështetet më tej nga krijimi i katër manualeve të specializuara që synojnë gjuhën e urrejtjes, punën me të rinjtë, ndërhyrjen e kalimtarëve dhe iniciativat kundër urrejtjes dhe bullizimit.

Përveç kësaj, departamenti ynë i Këshillimit është i përkushtuar të zgjerojë shërbimet e tij për të trajtuar dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, krahas kryerjes së hulumtimeve përkatëse. Një plan kyç i zgjerimit përfshin hapjen e një qendre të re në rajonin e Pejës për të zgjeruar ndikimin tonë.

Duke adresuar nevojat e brendshme organizative, viti 2024 shënon një vit transformues për strukturën e SIT. Në fund të vitit 2023 u bë një vlerësim gjithëpërfshirës i ekipit tonë nga Drejtori Ekzekutiv, ekipi menaxhues, Bordi Ekzekutiv dhe Kryesuesja e Kuvendit. Ky vlerësim ka çuar në ndryshime strategjike për vitin e ardhshëm, duke përfshirë shtimin e pozitive të reja si Zyrtare Administrative dhe për Burime Njerëzore, Kryesuesen e Departamentit të Hulumtimeve dhe trajnerë, të gjithë në përputhje me strategjinë në zhvillim dhe nevojat e programeve të SIT. Këto përmirësime në përbërjen e ekipit tonë dhe fokusin e programit janë hapa drejt realizimit të vizionit tonë për zhvillimin organizativ dhe zbatimin efektiv të projektieve. Për më tepër, SIT angazhohet në mënyrë aktive në dorëzimin e projekt propozimeve për donatorë të ndryshëm, duke mbajtur një ekip bazë dhe të përkushtuar të fokusuar në rrjetëzimin dhe promovimin e organizatës. Ky ekip luan një rol vendimtar në përpjekjet për mbledhjen e fondeve, duke siguruar që SIT të vazhdojë të sigurojë mbështetjen e nevojshme për gamën e ndryshme të projekteve dhe nismave të saj.

Çka na pret në vitin 2024



Stabiliteti i SIT

Projektet e reja 2024:

- 1.Youth INC (Dhjetor 2023 - Nëntor 2025)
- 2.Këshillim për Parandalim (C4P 4.0) (janar - dhjetor 2024)
- 3.Fuqizimi i të rinjve të Kosovës për kohezion në komunitet (tetor 2023 - dhjetor 2025)
- 4.Poke the Bubble (maj 2023 - gusht 2026)
- 5.DouActism (janar 2023 - dhjetor 2024)

Ekipi 2024

Kadri Gashi – Drejtor Ekzekutiv

Njomza Berisha – Menaxhere për Zhvillim dhe Programe

Liridona Berisha Shabani – Zyrtare për Programe dhe Marrëdhënie me Publikun

Agon Osaj – Menaxher i Financave

Elma Berisha – Kryesuese e Departamentit për Hulumtim

Adnan Retkoceri – Koordinator i Projekteve dhe Terrenit

Fiona Haxhikadrija – Koordinatore e Projekteve

Rron Rama – Koordinator i Projekteve dhe Kampanjave

Elsa Rexhepaj – Asistente e Projekteve

Andjelija Vucinic – Facilitatore e Komunitetit

Arditë Shkodra – Zyrtare për Administratë dhe Burime Njerëzore

Strategjia e SIT 2024 - 2028

Strategjia e re për periudhën pesëvjeçare do të fokusohet kryesisht tek të rinjtë/rejat projektet e reja do të hartohen në bazë të kësaj. Artvizmi dhe “Eknomia Donat” do të jenë forca shtytëse pas ideve tona të reja për të punuar me të rinjtë/rejat dhe për t’i ndihmuar ata/o të përqafojnë vlerat shumë të nevojshme kur bëhet fjalë për punësimin, aftësitë e buta, dhe artin për aktivizëm. SIT ka zhvilluar gjithashtu katër manuale për të rinjtë, të cilat do të jenë pjesë e projekteve që janë relevante (gjuha e urrejtjes, puna me të rinjtë, ndërhyrja e kalimtarëve, kundër urrejtjes dhe bullizimit).

Departamenti i Këshillimit do të fokusohet në ofrimin e shërbimeve të këshillimit për kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, ndërkohë që do të kryejë edhe hulumtime përkatëse dhe lansimin e raporteve në fushën përkatëse. Hapja e një qendre në rajonin e Pejës do të jetë prioritet i departamentit.



SIT

Faleminderit!

Janar – Dhjetor 2023